

Zhvillohet workshopi Bllok 6 i Programit Rajonal në auditimet e performances për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë - Stokholm, 12-17 maj 2024

Pranë Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë u zhvillua në datat 12-17 maj, 2024 Bllok 6, takimi përmbyllës i programit të trajnimit për auditimet e performancës në kuadër të Programit Rajonal për vendet e Ballkanit Perëndimor dhe Turqisë organizuar nga ky institucion.



Në zbatim të këtij projekti, Kontrolli i Lartë i Shtetit ka ndërmarrë auditimin e performancës, me temë “*Shërbimi i Policisë në Përgjigje të Qytetarëve*”. Ky program i organizuar në 6 module, ka integruar sesione virtuale dhe takime me prezencë fizike të organizuara respektivisht në Shkup në datë 6-10 Mars 2023; në Vlorë në 4-7 Korrik 2023 dhe takimin përfundimtar të zhvilluar në Stokholm.

Përgjatë Bllok 6, pjesëmarrësit iu nënshtruan një procesi vlerësimi, duke përfshirë dy faza. Së pari, në analizimin e përmbytjes së një raporti auditimi performance, më pas në prezantimin e një teme të shqyrtuar gjatë workshopit, aktivitete të dizenuara për të testuar njohuritë e marra gjatë trajnimit si dhe për të zhvilluar aftësitë praktike dhe teorike të audituesve në përgatitjen dhe prezantimin e raporteve të auditimit të performancës. Gjithashtu, u organizuan punë në grup për të diskutuar mbi raportet e auditimit të SAI-ve pjesëmarrëse me fokus përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së raporteve të auditimit të performancës. Diskutimet gjatë sesioneve të punës u përqëndruan në rëndësinë e përmirësimit të metodologjive të auditimit të performancës. Pjesëmarrësit ndanë përvojat e tyre, mbi sfidat e hasura dhe mënyrat për t'i tejkaluar ato.



Në një ceremoni zyrtare, Auditorja e Përgjithshme e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Suedisë, znj. Helena Lindberg, shpërndau certifikatat dhe shprehu vlerësimin ndaj përfaqësuesve të vendeve pjesëmarrëse për rezultatet e arritura.

Programin e trajnimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit e kanë ndjekur dhe janë certifikuar si auditues të performancës: Blerta Hima, Salvi Deda dhe Jon Kraja.

Në përmbyllje, u organizua një vizitë në Zyrën Kombëtare të Auditimit të Suedisë (SNAO), ku pjesëmarrësit u njohën me “Modelin Suedez” për auditimet e performancës. Gjatë kësaj vizite, u prezantua procesi i auditimit të performancës në SNAO, i cili përfshin një metodologji të detajuar dhe të strukturuar. Pjesëmarrësit u informuan mbi ndjekjen e rekomandimeve të dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit të Suedisë, publikimin e rezultateve të auditimeve, dhe ndikimin që këto rekomandime kanë në përmirësimin e performancës së institucioneve publike.

Kjo eksperienceë ishte një mundësi për të gjithë pjesëmarrësit për të zgjeruar kapacitetet profesionale dhe për të përfituar nga praktikat më të mira në fushën e auditimit të performancës.